

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	013
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	1914
Data:	
Datum:	17.06.2015
Date:	
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
 i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 17 qershor 2015

Ref. 238/018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, nenit 5 (5) të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimi Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ 10/2008 për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave dhe në bazë të kërkesës së DKA-së në Viti nr. 05-117/01 të datë: 05.06.2015, nxjerr:

V E N D I M

1. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Vëllezërit Gërvalla" në Lubishtë, Komuna e Vitisë, riemërtohet si Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Dëshmorët e Lubishtës".
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara dhe kërkesën e DKA-së në Viti nr. 05-117/01, dt. 05.06.2015, kërkesën e Këshillit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në Lubishtë, dt. 01.06.2015, Komisioni për Emërtimin dhe Riemërtimin e Shkollave në MASHT, në mbledhjen e mbajtur më 05.06.2015, shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në MASHT dhe konstatoi se lënda ka kaluar nëpër procedurë të rregullt. Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti, ka përkrahur propozimet dhe ka rekomanduar propozimin e bërë nga Këshilli i Shkollës të cilin e ka arsytuar me shkrim në kërkesën e dorëzuar në MASHT, prandaj Komisioni i MASHT miratoi propozimin që Shkolla Fillore e Mesme e Ulët të emërtohet "Dëshmorët e Lubishtës". Duke u mbështetur në këto argumente, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 30 ditësh në Komisionin për ankesa dhe parashtrës në MASHT.

Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë Komunale të Arsimit në Viti;
2. Shkollës Fillore e Mesme e Ulët në Lubishtë;
3. Komisionit për Emërtimin dhe Riemërtimin e Shkollave në MASHT;
4. Arkivit në MASHT.